



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1245/2 Prot.

Vlorë më, 30.04.2026

VENDIM

Nr. 23, datë 30.04.2026

PËR

**MIRATIMIN E KOMISIONIT ZGJEDHOR AD-HOC TË VLERËSIMIT TË
KANDIDATURAVE PËR ANËTAR TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË, PËRFAQËSUES I
UNIVERSITETIT**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja "gj", dhe të nenit 48, pika 1, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të nenit 19, pika 1, gërma "II", dhe nenit 24 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; të nenit 13, pika 22, të Rregullores së Brendshme të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; si dhe të neneve 19 dhe 20 të Rregullores së Senatit Akademik, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 30.04.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë Komisionin Zgjedhor ad-hoc për vlerësimin e kandidaturave për anëtar të Bordit të Administrimit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, përfaqësues të Universitetit si më poshtë:
 - Juliana Xhindoli (Kryetar)
 - Stela Frakulla (Anëtar)
 - Llambrini Sota (Anëtar)
2. Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve merr në shqyrtim dosjet e aplikantëve, të cilat janë tërhequr të protokolluara nga Zyra e Arkiv-Protokollit prej Sekretarit teknik të SA dhe i dorëzohen komisionit ditën e mbledhjes së tij.
3. Komisioni shqyrton përmbushjen e kritereve nga aplikantët, në përputhje me njoftimin e shpallur paraprakisht.
4. Mungesa e dokumentacionit shoqërues të kërkuar, sipas njoftimit, përbën shkak për skualifikimin e kandidatit nga gara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

5. Kur e çmon të nevojshme, Komisioni kërkon verifikimin e dokumentacionit nga strukturat përkatëse.
6. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioni harton relacion për përmbushjen ose jo të kriterëve nga secili kandidat.
7. Relacioni u bëhet i ditur kandidatëve aplikantë në mënyrë elektronike nga Sekretari teknik i Senatit Akademik.
8. Aplikantët kanë të drejtë të paraqesin ankim me shkrim mbi gjetjet e relacionit brenda 3 (tre) ditëve pune nga marrja e njoftimit, ndërsa Komisioni jep sqarimet përkatëse brenda 5 (pesë) ditëve pune.
9. Komisioni paraqet relacionin përfundimtar, së bashku me ankimimet dhe sqarimet përkatëse, pranë Kryetarit të Senatit Akademik.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**NËN KRYETAR I SENATIT AKADEMIK
Prof. Asoc . Denada Sota**

